

VENDIM
Nr.271, datë 10.5.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.54, DATË 28.1.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E LEJEVE
PROFESIONALE SPECIALISTËVE, QË KRYEJNË PROJEKTIMIN, VLERËSIMIN,
KONSULENCËN, MONITORIMIN DHE DREJTIMIN TEKNIK TË VEPRIMTARISË
MINERARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.54, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Procedurat për dhënien e lejes profesionale specialistëve, që kryejnë projektimin, vlerësimin, konsulencën, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë minerare, përcaktohen me rregullore, e cila miratohet nga Ministri.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha